

**DY PIKËPAMJE TË KUNDËRTA:**

**SI JU DUKEN QYTETARËVE  
MARRËDHËNIET BILATERALE TË KOSOVËS  
ME SERBINË DHE ME SHQIPËRINË?**



## Autorë:

Dea Fetiu, Mentor Vrajolli

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga sondazhi i Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e filluar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, e mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme të lidhura me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

**Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.**

Projekti financohet nga::

Konkursiumi drejtohet nga:

**DY PIKËPAMJE TË KUNDËRTA:**

**SI IU DUKEN QYTETARËVE MARRËDHËNIET  
BILATERALE TË KOSOVËS ME SERBINË DHE  
ME SHQIPËRINË?**



## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive .....	1
Metodologjia .....	3
1. Perceptimi i përgjithshëm i qytetarëve të Kosovës për Serbinë, për Shqipërinë, si dhe për qytetarët e shteteve përkatëse.....	4
2. Perceptimet e qytetarëve për dialogun dhe marrëdhëniet dypalëshe mes Kosovës dhe Serbisë .....	9
3. Perceptimet e qytetarëve për marrëdhëniet dypalëshe mes Kosovës dhe Shqipërisë.....	17
Përfundimet kyçe .....	20



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport shqyrton perceptimin e qytetarëve kosovarë për marrëdhëniet dypalëshe mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe mes Kosovës e Shqipërisë. Raporti është i ndarë në tre kapituj, ku elaborohen gjetjet për perceptimet e qytetarëve në lidhje me distancimin etnik me të dy shtetet, marrëdhëniet dypalëshe mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe marrëdhëniet dypalëshe mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Qytetarët kosovarë e perceptojnë Shqipërinë si partnerin më të madh dhe si shtetin me ndikimin më të madh pozitiv në Kosovë prej vendeve të rajonit. Nga ana e kundërt, Serbia perceptohet si vendi më pak miqësor për Kosovën prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, pasi që shumica dërrmuese e të anketuarve e vlerësojnë si keqdashës ndikimin e Serbisë ndaj Kosovës.

Sa u përket marrëdhënieve ndërmjet qytetarëve, të anketuarit kosovarë kanë shprehur qëndrime pozitive në lidhje me ndërtimin e bashkëjetesës, bashkëpunimin dhe zhvillimin e besimit ndërpersonal me qytetarë të Shqipërisë. Krejtësisht i kundërt është qëndrimi tejet negativ i të anketuarve në lidhje me krijimin e këtyre marrëdhënieve me qytetarët e Serbisë. Të anketuarit shprehin ngurrim veçanërisht në lidhje me zhvillimin e besimit ndërpersonal me qytetarë të Serbisë, konkretisht kur flitet për mundësinë e krijimi të marrëdhënieve familjare me ta.

Sa u përket marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, qytetarët shprehin mbështetje të lartë për dialogun Kosovë-Serbi. Sidoqoftë, edhe pse shprehin mbështetje, qytetarët priren të jenë shumë skeptikë në bazë të vlerësimit të suksesit të dialogut, pasi që shumica e tyre perceptojnë se deri më sot dialogu nuk ka qenë i suksesshëm në përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe. Për më tepër, qytetarët duket se janë tejet pesimistë se marrëveshja përfundimtare do të materializohet së shpejti, por gjithashtu besojnë se në të ardhmen e afërt do të ketë paqe mes dy shteteve. Të anketuarit gjithashtu besojnë se Kosova nuk do të pësojë pasoja të rënda nëse nuk arrihet marrëveshja dhe, përkundër mbështetjes së fuqishme për dialogun, mendojnë se zhvillimi i Kosovës është i mundur pa rezultat pozitiv nga ky proces.

Është befasues fakti se 96 për qind e qytetarëve vërejnë se nuk kanë përjetuar përfitime personale nga procesi i dialogut dhe shumica dërrmuese e tyre e vlerësojnë si shumë të ulët transparencën e tij. Gjithashtu, më shumë se gjysma e tyre nuk janë në dijeni për synimin e Kosovës në dialog. Përkundër mungesës së njohurive, ata besojnë në pozicionin e qeverisë aktuale në

procesin e dialogut dhe mendojnë se ajo është e orientuar drejt një dialogu të suksesshëm dhe normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve.

Sa u përket zgjidhjeve të dialogut, qytetarët e Kosovës e vlerësojnë njohjen e ndërsjellë si rezultat më të mirë nga dialogu dhe zgjidhjen kyçe për normalizimin e marrëdhënieve. Në lidhje me fushat e bashkëpunimit, të anketuarit vlerësojnë se bashkëpunimi ekonomik dhe politik është forma më produktive e bashkëpunimit për avancim drejt marrëdhënieve më të mira dypalëshe mes Kosovës dhe Serbisë. Ata besojnë se kontributin më të madh për këtë kauzë po e jep komuniteti ndërkombëtar, ndërsa udhëheqësit politikë lokalë janë akterët më të dëmshëm. Në kuadër të këtij komuniteti ndërkombëtar, qytetarët e Kosovës nuk janë shumë të kënaqur me mbikëqyrjen e dialogut nga BE-ja dhe do të dëshironin prani më të madhe të SHBA-ve në procesin e facilitimit të dialogut.

Në pyetjen nëse Shqipëria duhet të përfshihet në politikën e brendshme të Kosovës, pak më shumë se gjysma e qytetarëve nuk do ta preferonin këtë gjë. Nga ana tjetër, shumica dërrmuese besojnë se Shqipëria do të duhej të luante rol aktiv kur flitet për marrëdhëniet e Kosovës me vendet e tjera të rajonit. Në këtë aspekt, po ashtu, shumica e të anketuarve mendojnë se Kosova dhe Shqipëria do të duhej ta koordinojnë dhe unifikojnë politikën e jashtme.

Qytetarët e Kosovës pajtohen që Kosova dhe Shqipëria do të duhej t'i përmirësojnë edhe më tej marrëdhëniet e tyre, si dhe vlerësojnë se të dyja qeveritë janë përgjegjëse për barrierat ekonomike mes dy shteteve. Ata pajtohen gjithashtu që pikat e kontrollit kufitar mes dy shteteve do të duhej të hiqen dhe më shumë se gjysma e tyre e mbështesin idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.



## METODOLOGJIA

Analiza e këtij raporti bazohet në rezultatet e anketës përmes intervistave sy më sy me të anketuar të përzgjedhur rastësisht në mbarë Kosovën. Hulumtimi në terren u krye në periudhën 17-25 shtator 2021. Pyetësi i anketës përbëhej kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën përfshinte 1,197 amvisëri. Faza e parë e tërheqjes së mostrës u bazua në njësitë administrative të drejtorive rajonale të Policisë së Kosovës, duke përfshirë tetë rajonet: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Numri i anketimeve të kryera në secilin rajon u përcaktua në përpjesëtim me numrin e popullsisë për secilën komunë brenda rajoneve përkatëse bazuar në regjistrimin e popullsisë në Kosovë të vitit 2011. Brenda komunave, mostra u shtresua në mostër urbane/rurale bazuar në numrin e amvisërive në secilën zonë. Për përzgjedhjen e amvisërive brenda lokaliteteve të mostruara u përdorën modele të rastësishme, ndërsa rastësia brenda amvisërive u bazua në metodën e ditëlindjes radhës së të rriturve. Të dhënat u verifikuan në kohë reale përmes koordinatorëve në terren që vizituan një mostër të paracaktuar të amvisërive pas përfundimit të studimit në amvisëritë përkatëse, përmes kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit, për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa nga përgjigjet kyçe, si dhe duke analizuar konsistencën logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzhi i gabimit është 3 për qind me një interval besueshmërie prej 95 për qind.



# 1. PERCEPTIMI I PËRGJITHSHËM I QYTETARËVE TË KOSOVËS PËR SERBINË, PËR SHQIPËRINË, SI DHE PËR QYTETARËT E SHTETEVE PËRKATËSE

Bashkëpunimi ndërkuftar mbetet një nga segmentet më të rëndësishme të politikës së jashtme të Kosovës. Qeveria e Kosovës, si pjesë e procesit të Berlinit dhe rrugës drejt integritit në BE, po përpiqet të luajë rol konstruktiv dhe të jetë e përkushtuar ndaj përpjekjeve që i përmirësojnë më tej marrëdhëniet me fqinjët e vet. Sidoqoftë, ky proces mbetet shumë sfidues marrë parasysh se shumë marrëveshje nuk e kanë arritur eficiencën e planifikuar.

Është evidente se Serbia vazhdon të mbetet shteti fqinj më sfidues i Kosovës kur flitet për zhvillimin e marrëdhënieve pozitive dypalëshe. Edhe pse Kosova dhe Serbia tash e një dekadë janë ulur në tryezën e negociatave të mbikëqyrura nga BE-ja, stagnimi dhe ngeçjet e procesit të dialogut duket se pengojnë ndërtimin e marrëdhënieve funksionale mes dy shteteve. Mungesa e suksesit të prekshëm në dialog duket se e largon opinionin e përgjithshëm nga optimizmi dhe formëson një qëndrim skeptik ndaj një të ardhmeje të suksesshme të këtij procesi si dhe normalizimit të marrëdhënieve. Për më tepër, mosgatishmëria e Serbisë për ta njohur pavarësinë e Kosovës dhe ngurrimi për ta trajtuar si shtet sovran, veçse i shtojnë vështirësitë në procesin e krijimit të marrëdhënieve eficiente dypalëshe.



Ndryshe nga marrëdhëniet me Serbinë, marrëdhëniet e Kosovës me vendet fqinje kanë qenë shumë pozitive dhe me trajektore të vazhdueshme përmirësimi. Faktori kryesor për këtë është se, para së gjithash, vendet e tjera fqinje nuk duhet të kalojnë nëpër procesin e ballafaqimit me të kaluarën, i cili duket se është veçanërisht i vështirë për Serbinë dhe Kosovën. Rrjedhimisht, vendet e tjera fqinje shihen si promovues të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe të përkushtuara për forcimin e bashkëpunimit rajonal si pjesë e politikave të tyre të jashtme, drejt qëllimit të përbashkët - anëtarësimit në BE. Kjo vlen edhe për Shqipërinë, ku perceptimi për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duket se është më pozitiv krahasuar me çdo vend tjetër të rajonit. Sidoqoftë, kjo ndikohet në masë të madhe edhe nga faktori etnik. Tani e tutje, duket se Shqipëria ka potencial të madh që të ndikojë në Kosovë dhe tek qytetarët e saj.

Në përputhje me këtë, edhe anketa e BSBP-së ekspozon polarizimin reaktiv ndaj faktorit serb që ekziston në mesin e qytetarëve kosovarë, duke qenë se ata e nënvlerësojnë rëndësinë e faktorit serb në krahasim me atë shqiptar. Megjithatë, kjo mund të interpretohet përgjithësisht edhe si notë proteste ndaj qëndrimit armiqësor që shteti serb ka ndaj Kosovës. <sup>1</sup>



<sup>1</sup> Fokus grupi me hulumtues në terren të BSBP, 2021



**TABELA 1** REZULTATET E BSBP-SË – PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR NDIKIMIN E SHTETEVE VIJUESE NDAJ KOSOVËS

SI E KONSIDERONI NDIKIMIN E SHTETEVE VIJUESE NDAJ KOSOVËS?		Pozitiv	Negativ	Neutral/ Nuk e di
	Serbia	4%	90%	6%
	Shqipëria	77%	10%	13%

**TABELA 2** REZULTATET E BSBP-SË – PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR RËNDËSINË E SHQIPTARËVE DHE SERBËVE PËR BALLKANIN

A MENDONI SE SHQIPTARËT DHE SERBËT JANË FAKTORË TË RËNDËSISHËM NË BALLKAN?		Po	Deri diku	Jo	Nuk e di/ Nuk kam opinion
	Serbs	49%	22%	26%	3%
	Albanians	75%	16%	7%	2%

Marrë parasysh këto perceptime, është e qartë se tensionet ekzistuese në nivel shtetëror mes Kosovës dhe Serbisë kontribuojnë në zgjerimin e hendekut të distancimit etnik ndërmjet qytetarëve përkatës, çka nuk ndodhë mes Kosovës dhe Shqipërisë, ku mundësitë për komunikim të ndërsjellë pa asnjë pengesë mes qytetarëve përkatës, kanë qenë të pakufizuara gjatë dy dekadave të fundit.

Kjo bëhet e qartë kur analizohen treguesit e diversitetit të BSBP-së. Sipas rezultateve të këtyre treguesve, ndryshe nga qytetarët e Shqipërisë, të anketuarit kosovarë duket se nuk kanë interes të madh për të bashkëjetuar; bashkëpunuar; ose zhvilluar marrëdhënie të besimit ndërpersonal me qytetarë të Serbisë.

**TABELA 3** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MARRËDHËNIET E BASHKËJETESËS MES QYTETARËVE TË KOSOVËS DHE QYTETARËVE TË SERBISË OSE SHQIPËRISË

A DO TË PRANONIT QYTETARË NGA SERBIA QË:	Po	Jo	Nuk e di/nuk kam opinion
të jetojnë në Kosovë?	47%	52%	1%
të jetojnë në lagjen/ rrugën/ ndërtesën tuaj	39%	60%	1%
A DO TË PRANONIT QYTETARË NGA SHQIPËRIA QË:	Po	Jo	Nuk e di/nuk kam opinion
të jetojnë në Kosovë?	92%	7%	1%
të jetojnë në lagjen/rrugën/banesën tuaj?	92%	7%	1%

**TABELA 4** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MARRËDHËNIET E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET QYTETARËVE TË KOSOVËS DHE QYTETARËVE TË SERBISË OSE SHQIPËRISË

A DO TË PRANONIT QYTETARË NGA SERBIA QË:	Po	Jo	Nuk e di/nuk kam opinion
të punoni së bashku si kolegë?	44%	55%	1%
të jenë mbikëqyrësi juaj?	28%	71%	1%
të shërbejnë si zyrtarë publikë?	33%	66%	1%
A DO TË PRANONIT QYTETARË NGA SHQIPËRIA QË:	Po	Jo	Nuk e di/nuk kam opinion
të punoni së bashku si kolegë?	94%	5%	1%
të jenë mbikëqyrësi juaj?	89%	10%	1%
të shërbejnë si zyrtarë publikë?	90%	9%	1%

**TABELA 5** REZULTATET E BSBP-SË – PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR ZHVILLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË BESIMIT NDËRPERSONAL MES QYTETARËVE TË KOSOVËS DHE QYTETARËVE TË SERBISË OSE SHQIPËRISË

A DO TË PRANONIT QYTETARË NGA SERBIA QË:	Po	Jo	Nuk e di/nuk kam opinion
të jeni shokë?	27%	72%	1%
të martohen me një anëtar të familjes?	10%	89%	1%
t'i edukojnë/japin mësim fëmijëve tuaj?	20%	79%	1%
A DO TË PRANONIT QYTETARË NGA SHQIPËRIA QË:	Po	Jo	Nuk e di/nuk kam opinion
të jeni shokë?	93%	6%	1%
të martohen me një anëtar të familjes?	77%	21%	2%
t'i edukojnë/japin mësim fëmijëve tuaj?	92%	7%	1%

Megjithatë, përkundër faktit se rezultatet e mësipërme në shikim të parë tregojnë se marrëdhëniet dypalëshe të Kosovës me Serbinë dhe Shqipërinë, përkatësisht, duken se ecin në drejtime të qarta, rezultatet e BSBP-së për të dyja temat duket se vënë në dukje edhe praninë e shumë nuancave. Për më tepër, në rastin e Serbisë, edhe pse marrëdhëniet dypalëshe vazhdojnë të mbeten të mbërthyera në të kaluarën e trazuar, dialogu i vazhdueshëm i lehtësuar nga BE-ja, i cili po zhvillohet prej më shumë se një dekade, mbetet agjent i rëndësishëm që i mban gjallë shpresat se do të gjehet çelësi për zhbllokimin e mosmarrëveshjeve dypalëshe.<sup>2</sup> Andaj, elaborimi i këtij procesi të rëndësishëm nga këndvështrimi i qytetarëve është mjet shumë i rëndësishëm jo vetëm për të matur gjendjen aktuale në të cilën ndodhen këto marrëdhënie dypalëshe, por edhe për të shërbyer si mjet avokimi që i shtyn institucionet qeveritare të Kosovës të jenë proaktive si dhe llogaridhënëse në raport me këtë proces.

2 Fokus grup me akterë relevantë, 2021

Nga ana tjetër, në rastin e Shqipërisë, ndonëse gjatë viteve të fundit ka avancuar bashkëpunimi dhe shkëmbimi ndërkulturor mes qytetarëve në të dy vendet, bashkëpunimi ndërshtetëror në planin politik dhe ekonomik nuk ka ndjekur domosdoshmërisht të njëjtën dinamikë. Andaj, identifikimi i mangësive që po ndikojnë në bashkëpunimin e përbashkët në planin politik dhe ekonomik përmes këndvështrimit të qytetarëve dhe avokimi me të dyja qeveritë përkatëse për adresimin e këtyre sfidave, mbeten veprime me rëndësi të madhe për qytetarët e të dy vendeve.

Në pjesën vijuese të raportit paraqiten perceptimet e qytetarëve për marrëdhëniet ekzistuese dypalëshe mes Qeverisë së Kosovës dhe Serbisë nga njëra anë dhe të Kosovës me Shqipërinë nga ana tjetër, duke u fokusuar në specifikat kyçe që lidhen me kontekstet përkatëse.



## 2. PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR DIALOGUN DHE MARRËDHËNIET DYPALËSHE MES KOSOVËS DHE SERBISË

Përveç matjes së marrëdhënieve ndërmjet qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të Serbisë, një nga synimet kryesore të BSBP-së është matja e perceptimeve për marrëdhëniet dypalëshe mes Kosovës dhe Serbisë, me theks të veçantë në dialogun në vazhdim mes dy qeverive. Fokusi i kësaj pjese është elaborimi i perceptimit të qytetarëve, duke u përqendruar në disa elemente kyçe që lidhen me procesin e dialogut, siç janë: kuptimi i qëllimeve, mbështetja dhe kënaqshmëria e tyre e deritanishme me këtë proces; optimizmi i tyre për përfundimin e këtij procesi; perceptimet e tyre ndaj pasojave të mundshme nëse procesi dështon në lidhje me proceset integruese dhe zhvillimore; mbështetja e tyre ndaj platformës së dialogut qeveritar; dhe pikëpamja e tyre ndaj lehtësuesve ndërkombëtarë të dialogut.


Përgjithësisht, rezultatet e anketës tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë ndjenja të përziera kur bëhet fjalë për dialogun Kosovë-Serbi. Sidoqoftë, kjo duket e pashmangshme marrë parasysh se deri më tani ky proces ka qenë shumë i vështirë dhe ka pësuar stagnim dhe ngecje të mëdha, duke përfshirë mospërputhjet në zbatimin e marrëveshjeve dhe faktin se rezultatet konkrete janë shumë të kufizuara.

BSBP-ja tregon se qytetarët e Kosovës kanë prirje ta kuptojnë rëndësinë e dialogut. Kjo shihet qartë nga fakti se shumica dërrmuese e tyre shprehin mbështetje për këtë proces. Sidoqoftë, ata menjëherë shtojnë rezervat e tyre për mënyrën si ka ecur ky proces deri më tani dhe masën në të cilën ky proces ka sjellë rezultate konkrete. Rreth 85 për qind e të anketuarve e vunë në pyetje transparencën e procesit të dialogut dhe 94 për qind e tyre mendojnë se ky proces dhjetëvjeçar nuk u ka sjellë ndonjë përfitim personal konkret. Për më tepër, teksa pothuajse 80 për qind e të anketuarve mendojnë se dialogu nuk i ka përmirësuar marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, mes të anketuarve janë edhe 11 për qind që mendojnë se marrëdhëniet mes dy vendeve vetëm janë përkeqësuar gjatë kësaj periudhe.

**TABELA 6** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MBËSHTETJEN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI

**A E MBËSHTESNI  
DIALOGUN KOSOVË  
SERBI**


Nuk e di 5%  
Po 74%  
Jo 21%



**TABELA 7** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR PËRFITIMET PERSONALE NGA DIALOGU

**A KENI PËRJETUAR  
NDONJË PËRFITIM  
PERSONAL NGA  
DIALOGU KOSOVË-  
SERBI?**


Nuk e di 2%  
Po 2%  
Jo 96%



**TABELA 8** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR TRANSPARENCËN E DIALOGUT

**A MENDONI  
SE KA QENË  
TRANSPARENT  
PROCESI I  
DIALOGUT MES  
KOSOVËS DHE  
SERBISË?**


Nuk e di/Nuk kam opinion 6%  
Po, procesi ka qenë transparent 9%  
Pjesërisht. Procesi nuk ka qenë edhe aq transparent 42%  
Jo, procesi ka qenë krejtësisht jo transparent 43%



**TABELA 9** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR SUKSESIN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI

**A MENDONI SE  
DIALOGU I KA  
PËRMIRËSUAR  
MARRËDHËNIET  
MES KOSOVËS DHE  
SERBISË?**



Nuk e di/Nuk kam opinion 5%  
Po, i ka përmirësuar marrëdhëniet 15%  
Jo, asgjë nuk e ka ndryshuar 69%  
Jo, marrëdhëniet e ndërsjella janë përkeqësuar 11%





Kjo mungesë e rezultateve të prekshme e ndërë nga publiku, së bashku me stagnimin e dukshëm të procesit të dialogut në terren, duket se pasqyrohen edhe në rritjen e skepticizmit kur flitet për mundësinë e arritjes së një zgjidhjeje përfundimtare në të ardhmen e afërt. Rezultatet e BSBP-së tani tregojnë se rreth 3/4 e të anketuarve dyshojnë se në të ardhmen e afërt mund të arrihet ndonjë marrëveshje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë. Ndërkohë, edhe pse opinionet duken të ndara, më shumë se gjysma e qytetarëve të Kosovës besojnë se në të ardhmen e parashikueshme do të vazhdojë të ketë paqe mes Kosovës dhe Serbisë, pavarësisht nëse arrihet marrëveshja apo jo.

**TABELA 10** REZULTATET E BSBP-SË- PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR TË ARDHMEN E MARRËDHËNIEVE KOSOVË-SERBI

**A MENDONI SE KOSOVA DHE SERBIA DO TË ARRIJNË MARRËVESHJE PËRFUNDIMTARE?**





**A BESONI SE NË TË ARDHMEN E AFËRT DO TË KETË PAQE MES KOSOVËS DHE SERBISË?**





Siç u vu re, të anketuarit u pyetën edhe për ndikimin që mund të ketë dështimi i mundshëm i dialogut në procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE. Rezultatet tregojnë se shumë prej të anketuarve ndajnë shqetësimin se Kosova do të ketë pasoja nëse nuk arrihet marrëveshja me Serbinë, edhe pse shumica e tyre besojnë se këto pasoja nuk do të jenë të pakalueshme. Të njëjtat indikacione kanë rezultuar edhe nga përgjigjet në pyetjen e drejtpërdrejtë nëse Kosova do të mundet të përparojë në zhvillimin e shtetësisë së saj pa arritur marrëveshje, ku 72 për qind e të anketuarve besonin se ky nuk do të jetë problem madhor.

**TABELA 11** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR PASOJAT E DËSHTIMIT TË DIALOGUT

**A MENDONI SE DO TË KETË PASOJA NEGATIVE PËR KOSOVËN NËSE MARRËVESHJA NUK ARRIHET?**




**A MENDONI SE ZHVILLIMI I KOSOVËS ËSHTË I MUNDUR PA NJË MARRËVESHJE?**



Më tej, të anketuarit u pyetën nëse e mbështesin qëndrimin e Qeverisë në lidhje me dialogun dhe nëse besojnë se ka vullnet nga Kosova që ky proces të përfundojë me sukses. Rezultatet tregojnë se në përgjithësi qytetarët e mbështesin qëndrimin e Qeverisë së Kosovës në dialog, ku më shumë se 79 për qind besojnë në përkushtimin e kryeministrit Kurti për dialogun dhe në vullnetin e tij për të pasur sukses. Ky rezultat duket shumë inkurajues, edhe pse tingëllon kontradiktor, marrë parasysh faktin se qytetarët duken kryesisht të painformuar për synimin e Kosovës në këtë proces. Sidoqoftë, kjo tregon edhe një herë se deri më tani dialogu është konsideruar kryesisht si një proces i drejtuar nga lart-poshtë, dhe se qytetarët duket se nuk janë shumë të kënaqur me këtë.

**TABELA 12** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MBËSHTETJEN E POZITËS SË KOSOVËS NË DIALOG




Nga ana tjetër, qytetarët u pyetën për rezultatin e dialogut. Është evidente se të anketuarit kosovarë, në mënyrë pothuajse unanime, besojnë se Serbia duhet ta njohë shtetësinë e Kosovës, dhe në masë dërmuese e listojnë njohjen reciproke si të vetmen zgjidhje të mundshme përfundimtare të dialogut



Kosovë-Serbi. Njohja e ndërsjellë kryeson edhe kur flitet për mënyrën më të mirë për normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe mes dy vendeve, por edhe përmirësimi të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik, bashkëpunimi politik, si dhe lehtësimi i kontakteve ndërmjet njerëzve, theksohen si faktorë kyç që mund të çojnë drejt normalizimit të marrëdhënieve të ndërsjella.

**TABELA 13** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR DIALOGUN DHE NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE




QYTYRI	PËRÇYLLIMET	PROCENTAZHET
<b>CILA DO TË ISHTE ZGJIDHJA MË E MIRË PËR DIALOGUN KOSOVË SERBI?</b>	Njohja reciproke	75%
	Një marrëveshje që nuk konsiston në njohje reciproke por në anëtarësim në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare (përfshirë formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, status të veçantë për manastiret)	9%
	Kthimi i Kosovës me autonomi të gjerë në Serbi	3%
	Njohja e ndërsjellë me shkëmbime të territoreve	3%
	Asnjë nga të mësipërmet	5%
	Nuk e di/Nuk kam opinion	5%
	<b>CILA ËSHTË ZGJIDHJA PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES KOSOVËS DHE SERBISË?</b>	Zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur dhe dënimi i kriminelëve të luftës
Njohja e ndërsjellë në këmbim të anëtarësimit në BE për Serbinë dhe Kosovën		34%
Zhvillimi ekonomik i të dy vendeve dhe përmirësimi i marrëdhënieve ekonomike		26%
Tjetër		13%




BSBP-ja po ashtu mati rolin e akterëve të ndryshëm të brendshëm dhe ndërkombëtarë në procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Rezultatet tregojnë se komuniteti ndërkombëtar prinë në pyetjen se kush po kontribuon më shumë që normalizimi i marrëdhënieve të ketë sukses, pasuar nga udhëheqësit politikë dhe komuniteti i biznesit. Ndërkohë, në pyetjen se kush po e dëmton më shumë këtë proces, pothuajse 2/3 e të anketuarve vunë në dukje se udhëheqësit politikë lokalë janë akterët më të dëmshëm.

Nga ana tjetër, kur flitet për komunitetin ndërkombëtar, qytetarët duket se janë më së shumti të pakënaqur me BE-në si facilituese kryesore e këtij dialogu. Shumica e të anketuarve do të preferonin përfshirjen e drejtpërdrejtë të Shteteve të Bashkuara në këtë proces, qoftë së bashku me BE-në, ose si mbikëqyrës i vetëm i këtij procesi. Kjo, në një formë, pasqyron mbështetjen dhe besimin që kanë qytetarët kosovarë ndaj SHBA-ve. Por, nga ana tjetër, tregon gjithashtu se BE-ja deri më tani nuk shihet si e suksesshme kur flitet për lehtësimin e këtij procesi drejt arritjes së rezultateve konkrete të dialogut.<sup>3</sup>

**TABELA 14** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR NDIKUESIT POZITIVË DHE NEGATIVË NË DIALOG












<sup>3</sup> Për analizën e detajuar se si e vlerësojnë qytetarët punën e BE-së si ndërmjetësuese në dialog, lexoni raportin e QKSS "Perceptimet e qytetarëve për Perspektivën e Integritimit Evropian të Kosovës dhe Bashkëpunimin Rajonal dhe Ndërkombëtar" këtu: <https://qkss.org/al/publikimet/perceptimi-i-qytetareve-per-perspektiven-integritimit-te-kosoves-ne-be-dhe-bashkepunimin-rajonal-e-nderkombetar/>



Në fund të kësaj pjese, anketa e BSBP-së mati nivelin e sigurisë që do të ndjenin qytetarët kosovarë gjatë udhëtimit nëpër Serbi. Vetëm një e katërta e qytetarëve deklaruan se ndihen të sigurt, ndërsa shumica e të tjerëve shprehin siguri të pjeshme apo pasiguri. Kjo tregon se dialogu duhet ende t'i arrijë plot synime të rëndësishme teknike dhe politike, sidomos në lidhje me lirinë e lëvizjes dhe shkëmbimet ndërmjet njerëzve, ku siguria dhe besimi i ndërsjellë luajnë rol vendimtar. Në të vërtetë, është shumë e rëndësishme që drejtimi i pjesëve të ardhshme të procesit të dialogut, krahas objektivave për arritjen e marrëveshjeve politike, të fokusohet edhe në përmirësimin e sigurisë reciproke dhe ndjenjave të besimit ndërmjet qytetarëve përkatës, të cilat vinë nga liria e lëvizjes dhe shkëmbimet ndërmjet njerëzve.

Një pikë tjetër që elaborohet në këtë pjesë, lidhet me burimet ku informohen qytetarët e Kosovës për marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Televizioni, si medium tradicional, duket se mbetet burimi kryesor ku qytetarët e Kosovës informohen për këtë çështje. Megjithatë, edhe interneti (kryesisht portalet e lajmeve online dhe rrjetet sociale) rezulton si burim i rëndësishëm informacioni që përdoret nga qytetarët e Kosovës për marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Raportimi objektiv dhe i besueshëm prej mediave në lidhje me këtë proces, është shumë i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi që ndihmon në përmirësimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që të ketë monitorim të vazhdueshëm të mediave për të garantuar që informacioni i prodhuar nga to të jetë objektiv, si dhe të denoncohet në kohë çdo dezinformim dhe përmbajtje keqdashëse.

**TABELA 15** REZULTATET E BSBP-SË - PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR BURIMET E INFORMACIONIT DHE SIGURINË E UDHËTIMIT

<b>SA TË SIGURT DO TË NDIHESHIT PO TË UDHËTONIT NË SERBI?</b>	I/e sigurt		24%
	Deri diku i/e sigurt		28%
	Jo i/e sigurt		46%
	Nuk e di/Nuk kam opinion		2%
<b>KU I MERRNI INFORMACIONET PËR MARRËDHËNIET KOSOVË-SERBI?</b>	TV		62%
	Interneti		33%
	Diskutime në familje		2%
	Tjetër		2%
	Nuk e di/Nuk kam opinion		1%



### 3. PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MARRËDHËNIET DYPALËSHE MES KOSOVËS DHE SHQIPËRISË


Siç u përmend më herët, qytetarët kosovarë e perceptojnë Shqipërinë si vendin më miqësor në rajon. Sidoqoftë, ka ende vend për përmirësim në nivelin ekzistues të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë në frontet politike dhe të shkëmbimeve kulturore dhe ekonomike. Në këtë pikë, disa nga të anketuarit kishin prirje ta konsideronin qeverinë e Shqipërisë si jo mjaftueshëm delikate ndaj pozicionit të ndjeshëm të Kosovës, si në nivel rajonal ashtu edhe atë ndërkombëtar.<sup>4</sup> Në të njëjtën kohë, edhe pse shkëmbimet ndërmjet njerëzve dhe të mallrave mes Kosovës dhe Shqipërisë janë relativisht të shëndosha tani, në të kaluarën kur flitet për importimin e mallrave të veçanta, ka pasur raste të herëpashershme të barrierave të përkohshme të vendosura nga të dy shtetet ndaj njëri-tjetrit. Kjo ka kontribuar në frenimin deri diku të bashkëpunimit ekonomik, duke e mbajtur relativisht të ulët balancën import-eksport. Marrë parasysh këtë, anketa e BSBP-së e realizuar në Kosovë, mati perceptimin e qytetarëve për të gjitha fushat kryesore politike.

Sa u përket çështjeve politike, rezultatet e anketës së BSBP-së tregojnë se pak më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se qeveria e Shqipërisë nuk duhet të përfshihet paralelisht në çështje të politikës së brendshme të Kosovës, siç janë dialogu Kosovë-Serbi dhe zhvillime të tjera të brendshme politike. Qytetarët ndihen ndryshe në lidhje me rolin aktiv të Shqipërisë në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e Kosovës me shtetet e tjera të rajonit, pasi shumica e tyre mendojnë se Shqipëria duhet të luajë rol aktiv në këtë pjesë të politikës së jashtme të Kosovës, në koordinim të ngushtë me Kosovën. Ngjashëm, më shumë se 2/3 e të anketuarve mendojnë se Kosova dhe Shqipëria duhet të kenë një politikë të jashtme të bashkërenduar në mënyrë të ndërsjellë. Kjo edhe më tej e thekson nevojën për politika të përbashkëta, për të cilën qytetarët besojnë që do të kontribuonte pozitivisht për të dy shtetet.

**TABELA 16** REZULTATET E BSBP-SË – PËRFSHIRJA E SHQIPËRISË NË POLITIKËN E KOSOVËS

**A BESONI SE QEVERIA E SHQIPËRISË DUHET TË PËRFSHIHET NË POLITIKËN E BRENDSHME TË KOSOVËS (SI DIALOGU KS-SRB, ZHVILLIMET E BRENDSHME POLITIKE ETJ.)?**


Nuk e di/Nuk kam opinion 4%  
Po 44%  
Jo 52%



4 Fokus grupi me hulumtues në terren të BSBP-së, 2021

<b>A MENDONI SE SHQIPËRIA DO TË DUHEJ TË LUANTE ROL AKTIV KUR FLITET PËR MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME VENDET E TJERA TË RAJONIT?</b>	Po Në mënyrë proaktive, pa pasur nevojë për pëlqim paraprak nga Kosova		24%
	Po Por vetëm me kërkesë specifike prej Kosovës		48%
	Jo		23%
	Nuk e di/Nuk kam opinion		5%

**A MENDONI SE KOSOVA DHE SHQIPËRIA DUHET TA KOORDINOJNË DHE UNIFIKOJNË POLITIKËN E JASHTME?**




Të anketuarit kosovarë theksuan nevojën e heqjes së pikave të kontrollit kufitar mes dy vendeve si zgjidhje kyçe për rritjen e shkëmbimit të ndërsjellë mes njerëzve dhe të mallrave. Po ashtu, më shumë se gjysma e të anketuarve shprehën përkrahje për idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

Sa u përket barrierave të vendosura nga qeveritë përkatëse ndaj mallrave të importuara, qytetarët kosovarë kryesisht mendojnë se të dyja qeveritë do të duhej ta mbajnë përgjegjësi për këtë, por qeverinë e Shqipërisë e fajësojnë pak më shumë.



Sa u përket barrierave ekonomike mes Kosovës dhe Shqipërisë, shumica e të anketuarve kosovarë mendojnë se përgjegjësi mbajnë të dyja qeveritë përkatëse. Pjesa tjetër e qytetarëve mbanë Qeverinë e Shqipërisë më shumë përgjegjëse se atë të Kosovës për barrierat ekonomike, ndërsa edhe faktori i krimit të organizuar shihet si një faktor dëmtes i këtij bashkëpunimi.

**TABELA 17** REZULTATET E BSBP-SË - PIKAT E KONTROLLIT KUFITAR DHE BASHKIMI I KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

**REZULTATET E BSBP-SË - BARRIERAT EKONOMIKE MES KOSOVËS DHE SHQIPËRISË**



**A E PËRKRAHNI IDENË E BASHKIMIT TË KOSOVËS ME SHQIPËRINË?**



**TABELA 18** REZULTATET E BSBP-SË - BARRIERAT EKONOMIKE MES KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

KUSH BESONI SE QËNDRON PAS BARRIERAVE EKONOMIKE MES KOSOVËS DHE SHQIPËRISË?	Procent
Qeveritë përkatëse në të dy vendet	57%
Qeveria e Shqipërisë	16%
Qeveria e Kosovës	2%
Komuniteti i biznesit	3%
Krimi i organizuar	8%
Shtete të tjera	2%
Tjetër	1%
Nuk e di/Nuk kam opinion	11%



## PËRFUNDIMET KYÇE

Është evidente se për dy arsye shumë të ndryshme, Shqipëria dhe Serbia janë dy vendet më të rëndësishme dhe më me ndikim për Kosovën. Sidoqoftë, teksa marrëdhëniet mes Kosovës dhe Shqipërisë janë thjesht temë e kalimit në një nivel tjetër bashkëpunimi, pa barriera të mëdha mes njërit-tjetrit, kjo nuk duket se vlen kur flitet për bashkëpunimin mes Kosovës dhe Serbisë.

Bashkëpunimi mes Kosovës dhe Serbisë në përgjithësi duket se ka mbetur në nivel relativisht të ulët. Kjo përfshin si nivelin politik ashtu edhe atë ndërmjet qytetarëve, çka nënkupton se ndërkohë që dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka ecur me ritëm relativisht të ngadaltë, kanë ngecur edhe përpjekjet për përmirësim të ndërveprimit ndërmjet qytetarëve. Qytetarët e Kosovës duket se e nënvlerësojnë rëndësinë e faktorit etnik serb në rajon, çka duket kryesisht si shprehje e protestës ndaj qëndrimit të kaluar dhe të sotëm të Serbisë ndaj Kosovës. Në të njëjtën kohë, ata shprehin ngurrim që t'i pranojnë qytetarët serbë në mjedisin e tyre jetësor, të punës apo privat, çka tregon se marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë nuk janë përmirësuar edhe aq shumë, edhe pse konflikti aktiv ka përfunduar më shumë se dy dekada më parë dhe përkundër vazhdimin të dialogut mes dy shteteve.

Sa i përket dialogut, anketa thekson se qytetarët e Kosovës janë të vetëdijshëm për rëndësinë e tij dhe e mbështesin atë. Sidoqoftë, ata duket se janë shumë të pakënaqur me progresin e arritur deri më tani në kuadër të këtij procesi. Veç kësaj, ata shprehin qasje mbështetëse ndaj qëndrimit dhe vullnetit të Qeverisë së Kosovës për progres në këtë proces. Sa u përket zgjidhjeve të mundshme për një marrëveshje përfundimtare, qytetarët besojnë se njohja e ndërsjellë është alternativa e vetme më e mirë që kjo të ndodhë. Sidoqoftë, marrë parasysh qëndrimin e Qeverisë së Serbisë në lidhje me këtë proces, të anketuarit duket se janë tejet pesimistë se kjo do të materializohet së shpejti.

Një vërejtje tepër e rëndësishme e vënë në dukje nga BSBP-ja, është gjithashtu fakti se qytetarët e Kosovës duket se janë kritikë ndaj aftësisë së BE-së për ta ndërmjetësuar këtë proces. Për këtë arsye, shumica e të anketuarve mendonin se është shumë e rëndësishme që SHBA-të të përfshihen në formë të drejtpërdrejt në proces.

Ndërkohë, rezultatet e BSBP-së theksojnë gjithashtu se përkundër faktit se qeveritë që i përfaqësojnë të dy shtetet ka vite që janë ulur në tryezën e negociatave, mosbesimi ndërmjet qytetarëve mbetet relativisht i lartë. Kjo mund të shihet nga fakti se shumica dërrmuese e qytetarëve të Kosovës ende



i frikësohen udhëtimit nëpër Serbi. Në të njëjtën kohë kjo ekspozon një fakt crucial që i ka munguar dialogut deri më tani – fokusi parësor në përmirësimin konkret të marrëdhënieve ndërmjet qytetarëve të të dy shteteve. Për këtë arsye, besimi i ndërsjellë mes qytetarëve në shtetet përkatëse vazhdon të mbetet në nivele të brishta dhe ka nevojë për përmirësim. Tani e tutje, kjo lloj qasjeje duhet të ndryshojë. Fokusi i dialogut do të duhej të kalonte më shumë drejt bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve të shteteve përkatëse. Që të ndodhë kjo, është shumë e rëndësishme që të përmirësohet transparenca gjatë këtij procesi, si dhe është thelbësore që procesi i dialogut të përcillet me debat gjithëpërfshirës mes palëve të interesit politike dhe joqeveritare, duke siguruar që fokusi parësor i dialogut të jetë t’u shërbejë interesave më të mira të qytetarëve të prekur drejtpërdrejt dhe jo narrativave nacionaliste dhe populiste.

Në lidhje me bashkëpunimin dypalësh me Shqipërinë, situata duket se është shumë më ndryshe. Qytetarët e Kosovës duket se kanë vlerësim të pakufishëm, si për shtetin ashtu edhe për qytetarët e Shqipërisë. Këtë mund ta tregojë edhe fakti se shumica dërrmuese e qytetarëve nuk do ta kishin problem të ndajnë mjedisin e të jetuarit, hapësirën e punës apo jetën personale me qytetarët nga Shqipëria.

Megjithatë, sipas përgjigjeve të tyre, qytetarët besojnë se bashkëpunimi mes Kosovës dhe Shqipërisë mund të zhvillohet edhe më tej drejt arritjes së potencialit të tij të plotë. Në veçanti, ata e vënë në pyetje qëndrimin e politikës së jashtme të Shqipërisë ndaj Kosovës në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi, bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet diplomatike në përgjithësi, duke kërkuar që ajo të jetë shumë më e sinkronizuar dhe më e koordinuar me atë kosovare.

Nga ana tjetër, të anketuarit mendojnë se duhet të përmirësohen më tej shkëmbimet e mallrave dhe ndërmjet njerëzve mes Kosovës dhe Shqipërisë. Për këtë, ata besojnë se është shumë e rëndësishme që liria e lëvizjes mes dy vendeve të avancojë në nivel tjetër, duke hequr kontrollin kufitar mes dy shteteve dhe barrierat ekzistuese dhe sporadike ndaj importeve, të cilat janë vendosur nga të dyja qeveritë përkatëse.

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

303.425.6(496.51)

*Dy pikëpamje të kundërta: Si iu duken qytetarëve marrëdhëniet dypalëshe të Kosovës me Serbinë dhe me Shqipërinë? / Dea Fetiu, Mentor Vrajolli. - Prishtina : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2022. - 20 f. : ilustr. ; 24 cm.*

*Testet e opinionit publik -- Kosovë*

**ISBN 978-9951-799-68-3**

*Aleph [000103327]*



ISBN 978-9951-799-68-3



9 789951 799683

